



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 05.03.2021, Nr. 09-111/01-10380



Në bazë të nenit 64 paragrafi 1 Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, vështrim të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 10/2018 të dt. 13/07/2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, në bazë të vendimit me nr. 01/37-46/20-A, të datës 10.07.2020 të Inspektorit të Punës në MPMS-Prishtinë dhe vendimit me nr. 437/2020 i datës 08.10.2020 të Inspektoriatit të Punës në Prishtinë, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, bënë këtë:

RISHPALLJE TE KONKURSIONIT

1. SHFMU” Bajram Curri ” në Nekoc

- Një mësimdhënës për arsim fillor, më afat të pacaktuar.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.10 / 2018.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
4. Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
5. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur më çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim, me gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-s, të plotësohet rrjedhshëm në Gjuhën Shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentët e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë afatit të dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,
Më:05.03.2021

